

SHPLLJE PËR LËVIZJE PARALELE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të Ligjit Nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII, të Vendimit Nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Bashkia Gjirokastrë shpall procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

**Specialist i Projektimit Inxhinierik, Sektori i Projektimit , Drejtoria e Urbanistikës
Kategoria e pages IV-2**

Pozicioni më sipër, i ofrohen fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Vetëm në rast se ky pozicion , në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vacant atëherë është I vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

**PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE, PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL)
APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për: LËVIZJE PARALELE
10.06.2026**

**Afati për dorëzimin e dokumentave për: PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL
15.06.2026**

Përshkrimi përgjithshëm i punës për pozicionin më sipër është:

1. Mbikqyr dhe koordinon punën në bashkëpunim me grupin e projektimit për procesin e hartimit të projekteve të infrastrukturës në funksion të PDV-së, që kryhen për rrugë, hapësira të gjelbërta, zona sportive e objekte shoqërore;
2. Mbikqyr dhe koordinon punën për procesin e hartimit të materialeve që paraqiten në Këshillin Bashkiak, si dhe ndjek zbatimin e vendimeve të miratuara;
3. Mbikqyr dhe koordinon punën për procesin e përgatitjes të një sistemi informacioni të nevojshëm për përshtatjen dhe grumbullimin e normave të projektimit;
4. Mbikqyr dhe koordinon punën për procesin e hartimit të metodologjisë së vlerësimit të projekteve dhe vlerëson opsionet nga pikëpamja e kostos, kohës së realizimit, cilësisë dhe impaktit;
5. Koordinon punën për procesin e hartimit dhe të organizimit të dokumentave për lejet për veprat publike, të llogaritjes së volumit të punimeve sipas projekteve, aplikimit të çmimeve sipas llojit të punimeve dhe të analizimit të çmimeve të reja (kur mungojnë në manual);
6. Verifikon dhe koordinon punën për procesin e kontrollit të përgjithshëm të preventivave që shoqërojnë projektet e hartuara nga studiot private.
7. Planifikon dhe kontrollon detyrat e projekteve, si dhe realizon procesin e ndjekjes së procedurave për miratimin e tyre;
8. Monitoron dhe verifikon dosjet e detyrave të projektimit, projekt-ideve/projekt-zbatimit dhe përgatit relacionet, raportimet në mbledhjet përkatesë, duke ndermarr masa që konkluzionet e identifikuar nga mbledhja të plotësohen dhe kompletohen në projektin e zbatimit, e pas miratimit të tyre përgatit dokumentacionin tekniko-ligjor për fillimin e procedurave të prokurimit;
9. Kontrollon, vlerëson dhe miraton detyrat e projektimit, projektet dhe preventivave të infrastrukturës të përgatitura nga strukturat pjesë e aparatit të Bashkisë, operatorë të kontraktuar, apo/dhe institucione të ndryshme;

1.1

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT PËR LEVIZJE PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon: `

- Lloji i diplomës , Arsimi I Lartë , Master Shkencor ose ekuivalent në degët Inxhinjieri Ndërtimi , Arkitekturë ose Gjeodet (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).

- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura .

1.2 Dokumentacioni, menyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë me postë ose fizikisht pranë Bashkisë Gjirokastër dokumentat si më poshtë:

1. Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
2. Fotokopje e noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
4. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
6. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
7. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
8. Vërtetim nga Institucioni që nuk ka mase disiplinore ne fuqi;
9. Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtëpërsëdrejti në brenda datës 10.06.2026 në Bashkinë Gjirokastër

1.3 Rezultatet e verifikimit paraprak te dokumentacionit

Në datën 12.06.2026 NJBMNJ do të shpallë në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. dhe ne stendat e Bashkisë, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme, do të njoftohen individualisht nga NJBMNJ, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

1.4 Fushat e Njohurive mbi te cilat do te zhvillohet intervista

- Njohuri mbi ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”;
- Njohuri mbi ligjin nr.152/2013 “Per nepunesin civil”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi ligjin Nr 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar,
- Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet .e kundra ligjshme.
- VKM Nr 408, datë 13.05.2015, ”Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” I ndryshuar,

1.5 MENYRA E VLERESIMIT TE KANDIDATEVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar. Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer. Totali i pikëve për këtë vlerësim **është 40 pikë**. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim **është 60 pikë**. Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjës së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike.

1.6 DATA E DALJES SE REZULTATIT DHE MENYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJMBNJ do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në portalin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nga NJBMNJ, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

2.PRANIM NE SHERBIMIN CIVIL

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a - Të jetë shtetas shqiptar;
- b - Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c - Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d - Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e - Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f - Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

➤ **Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:**

- Lloji i diplomës , Arsimi I Lartë , Master Shkencor ose ekuivalent në degët Inxhinjieri Ndërtimi , Arkitekturë ose Gjeodet (*Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjislacionit në fuqi*).
- Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe të punës në grup.
- Të zotërojnë gjuhën angleze. Përparësi ka një gjuhë e dytë e BE-së.
- Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vite, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura .

2.1 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si mëposhtë:

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>
- b- Fotokopje e noterizuar të diplomës (përfshirë edhe diplomën bachelor);
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni qe nuk ka mase disiplinore ne fuqi;
- i- Cdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtëpërsëdrejti në brenda datës 15.06.2026 në Bashkinë Gjirokastrë.

2.2 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 25.06.2026 Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të shpallë në stendat e Bashkisë dhe në portalin e “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”., listën e personave fitues, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në shërbimin civil dhe kriteret e veçanta do të njoftohen në rrugë elektronike.

2.3

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA

Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me:

- Njohuri mbi ligjin nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”;
- Njohuri mbi ligjin nr.152/2013 “Per nepunesin civil”, i ndryshuar;
- Njohuri mbi ligjin Nr 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” I ndryshuar,
- Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet .e kundra ligjshme.
- VKM Nr 408, Dt. 13.05.2015, ”Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” I ndryshuar,

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë, aftësitë, kompetencen në lidhje me përshkrimin e pozicioni të punës;
2. Eksperiencën e tyre të mëparshme;
3. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

2.4 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1-Vlerësimin me shkrim, derinë 60 pikë;

2-Intervistën e strukturuar me goje konsiston ne motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;

3-Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, derinë 15 pikë.

2.5

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, NJBNJ do të shpallë fituesin në stendën e Bashkisë dhe në portolin “Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”.. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet *(nëpërmjet adresës së e-mail)*

DREJTOR

Mirlinda Shabani